



BULETINI



MAJ 2025



9-11 Maj, Prevallë – Kampi i fundit rinor në kuadër të programit Youth Powered through Inclusive Schools and Societies (YESS) u organizua me sukses nga OJQ ACDC. Kampi mbledhi të rinjtë që morën pjesë në të gjitha kampet e mëparshme në Prizren, Graçanicë dhe Bogë. Gjatë qëndrimit treditor, pjesëmarrësit morën pjesë në punëtori gjuhësore (serbe dhe shqipe), detyra ekipore, lojëra kreative dhe sesione reflektuese. Qëllimi i kampeve ishte të kontribuonte në dialogun ndërkulturor dhe kompetencën gjuhësore përmes të mësuarit formal dhe joformal. Kjo ngjarje përfundoi simbolikisht ciklin shumëmuor të takimeve rinore.

Ky program është pjesë e projektit „Të rinjtë të fuqizuar përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)“, i financuar nga Fondi për Ndërtimin e Paqes i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe i zbatuar nga UNICEF dhe IOM Kosova.



14 Maj, Beograd – OJQ ACDC dhe BIRODI organizuan konferencën mbi perceptimet dhe qëndrimet reciproke të serbëve dhe shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe në veri të Kosovës. Hulumtimi shfaq pranimin e etno-nacionalizmit, përfaqësimin e ulët institucional dhe qëndrimet shqetësuese për konfliktet e ardhshme. Dushan Radaković (ACDC) dhe Zoran Gavrilloviq (BIRODI) i prezantuan rezultatet dhe theksuan nevojën për përqendrim më të madh në problemet e përditshme dhe bashkëpunimin, jashtë kornizës së politikës së lartë.



22 Maj, Mitrovicë Veriore – Në konferencën e ndërmjetësimit të organizuar nga ACDC, panelistët Ganimete Xhelili dhe Bekim Ismaili folën për rëndësinë e ndërmjetësimit si mekanizëm për zgjidhje të shpejtë, ekonomike dhe efikase të kontesteve civile. Ata theksuan rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të ndërmjetësuesve dhe promovimit të kësaj praktike në mesin e qytetarëve për të lehtësuar barrën e gjykatave dhe për të ofruar qasje më të mirë në drejtësi.



27 Maj, Graçanicë – ACDC organizoi tryezë të rrumbullakët me Avokatin e Popullit, Naim Qelaj dhe përfaqësues të organizatave që punojnë me personat me aftësi të kufizuara nga komuniteti serb. Fokusi ishte tek qasja në të drejta, përkthimi i ligjeve, arsimimi, punësimi dhe përfshirja e përfaqësuesve të komunitetit serb në Këshillin Kombëtar për Aftësi të Kufizuara. Qëllimi i takimit ishte inkurajimi i politikave më gjithëpërfshirëse dhe dialogu i drejtpërdrejtë ndërmjet komunitetit dhe institucioneve.



31 Maj, QKP "Aquarius" – Në kuadër të projektit për promovimin e përmbajtjes artistike dhe kulturore, ACDC organizoi koncertin e grupit mitrovicas Something Went Wrong. Grupi prezantoi këngë nga albumi i tyre i parë dhe përpunime të hiteve alternative. Ky grup elektro-pop njihet për shprehjen e tij autentike dhe kontribuon në ringjalljen e skenës kulturore në Mitrovicën e Veriut.

TAKIME ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË:

Aleksandar Rapajiq, drejtor programi në ACDC, mori pjesë në një takim me përfaqësuesit e EOM të BE-së, të cilët prezantuan raportin përfundimtar për zgjedhjet në Kosovë me rekomandime për përmirësimin e proceseve zgjedhore.



Aleksandar Rapajiq, drejtor programi në ACDC, mori pjesë në një takim me të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Amerikës Anna Prattipati gjatë vizitës së saj në veri të Kosovës, ku u diskutua për sigurinë dhe stabilitetin në rajon.



Dushan Radaković mori pjesë në takim me ambasadorin Gerard McGurk dhe përfaqësues të OSHC-ve të tjera, ku u theksua nevoja për të forcuar besimin reciprok, kohezionin social dhe qëndrueshmërinë e komunitetit.



Dushan Radaković, drejtor ekzekutiv i ACDC-së, mori pjesë në takimin punues të Forumit për dialog ndërmjet Avokatit të Popullit dhe OSHC-ve, ku u prezantuan objektivat e Planit të Punës për 2025/2026: mbrojtja e të drejtave të komuniteteve joshumicë, fëmijëve, grave, personave me aftësi të kufizuara, komunitetit LGBTQI+ dhe luftimit të dhunës kundër diskriminimit.



PROJEKTI I RI

8 Maj, Podgoricë – Andrea Todić, menaxhere e projektit në OJQ ACDC, nënshkroi kontratën në kuadër të projektit Bringing Pride in the North, i cili zbatohet përmes programit rajonal "Së bashku për Barazinë LGBTQI+". Projekti, i financuar nga BE-ja dhe i zbatuar nga CGE dhe partnerë nga disa vende, synon të promovojë barazinë, dukshmërinë dhe përfshirjen sociale të personave LGBTQI+ në komunat veriore të Kosovës përmes artit, hulumtimit, dialogut dhe bashkëpunimit institucional.



ACDC i'u bashkua fushatës së realizuar nga OJQ Aktiv, me qëllim të monitorimit të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë. Nga analiza rezulton se shoqëria civile vendos standardin në zbatimin e këtij ligji, ndërsa institucionet vazhdojnë të injorojnë detyrimin për përdorimin e barabartë të gjuhës serbe dhe shqipe. Më shumë në faqen e Aktiv.

NË FAQEN E ACDC-SË JANË PUBLIKUAR DY TEKSTE OP-ED TË REJA:



Muzika si reagim ndaj ndarjeve - për aktivitetet kulturore si një mjet për të kapërcyer ndarjet



Përvoja në kampet e të rinjve - dëshmi personale e një pjesëmarrësi për rëndësinë e kampeve dhe shkëmbimit ndërkulturor

Gjatë muajit maj të vitit 2025, janë regjistruar një sërë dukurish shqetësuese të sigurisë dhe institucioneve që kanë prekur drejtpërdrejt të drejtat, sigurinë dhe besimin e qytetarëve, veçanërisht të komunitetit serb, në punën e institucioneve të Kosovës. Në përgjigje të këtyre sfidave, pesë organizata të shoqërisë civile nga veriu i Kosovës – ACDC, Aktiv, NSI, Inter dhe CASA – publikuan deklarata dhe reagime të përbashkëta publike me qëllim që të theksojnë seriozitetin e situatës dhe të bëjnë thirrje për përgjegjësi institucionale dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut.

• Apel i përbashkët i shoqërisë civile drejtuar EULEX-it dhe akterëve ndërkombëtarë - për shkak të raporteve shqetësuese për ngacmimet e grave dhe vajzave në veri të Kosovës.

• Letër e hapur Avokatit të Popullit – kërkesë për sqarim të deklaratave që zvogëlojnë seriozitetin e reagimit institucional ndaj rasteve të ngacmimeve.

• Mbështetje për komunikatën për media të OJQ Aktiv - kundër akuzave të pabaza dhe të rrezikshme që synojnë organizatat e shoqërisë civile serbe.

• Përdorimi selektiv i forcës dhe paragjykimet etnike - reagim ndaj incidentit gjatë festës së diplomimit në Mitrovicën e Veriut.

• Letër drejtuar UNICEF-it dhe Avokatit të Popullit - shqetësimet për publikimin publik të fotografive të një të mituri nga Policia e Kosovës.

Njoftim lidhur me bllokimin e Kuvendit të Kosovës – në apelin e përbashkët të disa organizatave të shoqërisë civile, ACDC ka mbështetur thirrjen për përgjegjësi urgjente politike dhe vendosjen e funksionalitetit të institucioneve demokratike.

KONTAKT



office@acdc-kosovo.org



@acdc.kosovo



www.facebook.com/Ngoacdc



@ngo_acdc



www.acdc-kosovo.org

